



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 4 prot

Tiranë, më 10/10 2017

VENDIM

Nr. 4, datë 10.10 2017

**“PËR
TRANSFERIMIN E FUNKSIONIT KOLEKTIV TË MBLEDHJES SË TARIFAVE
TË SHPËRBLIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË E MBAJTËSVE TË TË
DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME
TO DREJT NJËRËS PREJ AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV
DHE PËR DREJTIMIN E SPORTEELIT UNIK PËR ADMINISTRIMIN E TË
DREJTËS SË AUTORIT - SUADA”**

Në zbatim të nenit 138 të ligjit Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit nr. 2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të orgnizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”,

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në mbledhjen e vet të radhës me rend dite ndër të tjera miratimin e agjencisë në favor të të cilës kalon funksioni kolektiv i mbledhjes së tarifave të shpërblimit në kuptim të nenit 138 të ligjit 35/3016 si dhe drejtimin prej saj të sportelit unik për kryerjen e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit, për të gjitha kategoritë e të drejtave që ato përfaqësojnë në administrimin kolektiv, në emër të të gjithë Agjencive të Administrimit Kolektiv (AAK), në bazë të nenit 138 të ligjit 35/2016, mori në shqyrtim dosjet me propozimet e mëposhtme:

- Propozimin e agjencisë “Forumi i Mbrojtjes për Autorë të Audiovizualit” (FMAA), me lëndë “Mendime dhe propozime mbi Sportelin Unik”, me nr. 95 prot, datë 31.08.2017.
- Propozimin e agjencisë “Agjencia e Administrimit Kolektiv e të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues (AKDIE), me lëndë “Prezantimi i agjencisë AKDIE për agjencinë “Sporteli Unik” sipas vendimit së KKDA-së dhe dokumentacioni shoqërues”, me nr. 66 Prot, datë 25.09.2017.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

- Propozimin e përbashkët të agjencive “Agjencia e Autorëve Shqiptar” (Albautor) dhe Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve (AMP) me objekt “ Kërkesë për transferimin e funksionimit të mbledhjes së tarifave (Sporteli Unik) Agjencisë AMP (Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve) sipas parashikimeve të nenit 138 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”, me nr. 70 Prot, datë 26.09.2017.

KKDA, në zbatim të ligjit 35/2016 saktëson se neni 138 pika 1, parashikon se: *“Me anë të një marrëveshjeje me shkrim AAK-të bien dakord dhe vendosin cilës prej tyre do t’i transferohet funksioni i mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave”.*

Në KKDA nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë marrëveshje midis të gjitha agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e këtij funksioni dhe duke qenë se palët kanë depozituar dy projekt propozime KKDA është organi kompetent për caktimin e njëres prej agjencive së cilës i kalojnë funksionet e mbledhjes së tarifave të shpërblimit si agjenci drejtuese e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit e (këtëj e tutje Agjencia drejtuese e SUADA). Kjo Agjenci drejtuese e SUADA për kryejën e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit ngarkohet të zbatojë Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv” si dhe vendimin e KKDA-së "Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv".

KKDA mori në shqyrtim propozimet e agjencive AKDIE, FMAA si dhe propozimin e përbashkët ALBAUTOR – AMP duke administruar informacionin e protokolluar dhe dëgjuar palët në seancë dëgjimore.

Propozimet e paraqitura të agjencisë AKDIE dhe ALBAUTOR - AMP parashtrojnë informacion për përmbushjen e kushteve të nenit 138, pika 2 e ligjit 35/2016, në mënyrë individuale për çdo kriter si dhe paraqesin projekt propozimet e tyre për strukturën dhe mënyrën e realizimit të funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit si një sportel unik.

Gjithashtu, përveç shkresave dhe dokumenteve mbështetëse të administruara nga ana e KKDA-së, palët individualisht prezantuan avantazhet e tyre, mënyrën e bashkëpunimit mes AAK-ve, organeve të tjera shtetërore në zinxhirin e zbatimit të kuadrit për të drejtën e autorit, kostrovet të administrimit, logjistikën, burimet njerëzore dhe infrastrukturën e përshtatshme për ushtrimin me efektivitet të funksionit si sportel unik, kushteve të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

transparencës dhe gjithëpërfshirjes, qasjen dhe ofrimit të shërbimit ndaj subjekteve përdorues dhe bashkëpunimeve me institucionet e tjera shtetërore etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe prezantimeve të projekt propozimeve në seancë dëgjimore KKDA ARSYETON se:

Kriteret e parashikuara në nenin 138 si dhe platforma më e përshtatshme dhe më efektive për kryejën e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit përmbushen në një shkallë më të lartë nga propozimi i përbashkët ALBAUTOR-AMP, propozim i cili mbështet ushtrimin e këtij funksioni nga Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve (AMP). Përveç kësaj, KKDA merr në konsideratë edhe raportin më të gjerë të forcave mbështetëse të AAK-ve për këtë propozim të përbashkët (Agjencia FMAA në seancë dëgjimore rendit shumë arsye, në mënyrë kategorike, kundër mbështetjes së propozimit të agjencisë AKDIE).

Platforma e propozuar nga ALBAUTOR-AMP përveç paraqitjes së garancive dhe mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë si agjenci e vetme për mbledhjen dhe shpërndarjen e tarifave të shpërblimit në emër të të gjithë agjencive të licencuara do të zbatohet edhe Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, konkretisht garantimit të parimeve të transparencës, thjeshtimit të aksesueshmërisë elektronike së dokumentacionit nga ana e subjekteve përdorues, llogaridhënies, efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes mes të gjithave AAK-ve dhe organeve të tjera kompetente. Udhëzimi në fjalë shërben edhe si një udhërrëfyes i qartë për Agjencinë drejtuese të SUADA që do t’i tranferohet funksioni i mbledhjes së tarifave të shpërblimit duke qenë se mungon eksperiencia e mëparshme në këtë drejtim si dhe ndihmon organet mbikëqyrëse shtetërore të monitorojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e Agjencisë drejtuese të SUADA si një sportel i përbashkët për të gjitha AAK-të.

Sa më sipër, duke administruar të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pas shqyrtimit të platformave të paraqitura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit në zbatim të nenit 138 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”,

VENDOSI:

1. T’i transferojë funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me

